

Sektor i veprave civile të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në bazë të nenit 68 nga Rregullorja gjyqësore ("Gazeta Zyrtare e RM" nr.66/2013 dhe 114/2014) dhe nenit 33 nga Rregullorja e punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr.14/2022), duke vepruar për konkluzionin e sektorëve civil të katër gjykatave të apelit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, mbi shqyrtimin e çështjes juridike për sigurimin e zbatimit unik të ligjit dhe harmonizimin e praktikës gjyqësore, në seancën e mbajtur më 21.03.2023, miratoi këtë:

M E N D I M J U R I D I K

Të punësuarit në policinë gjyqësore kanë të drejtë të rrogës bonus dhe kompensimin e shpenzimeve për ushqim për punën e natës në kushte të përcaktuara në nenin 117 paragrafi (4) dhe nenin 128 paragrafi (3) pika 2 të Ligjit për marrëdhënie pune.

A r s y e t i m

Në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut – Sektor i veprave civile është dorëzuar Konkluzioni i katër gjykatave të apelit të nxjerrë në takimin e punës të mbajtur më 08-09.06.2022, për unifikimin e praktikës gjyqësore për çështjen juridike, nëse të punësuarve në policinë gjyqësore-policëve gjyqësorë u takon rrogë bonus të përcaktuar në nenin 117 paragrafi (4) të Ligjit për marrëdhënie pune, si dhe kompensim të shpenzimeve për ushqim për punën e natës të përcaktuar në nenin 128 të LMP, duke qenë se këto kompensime nuk janë përcaktuar në Ligjin për shërbim gjyqësor, por janë përcaktuar me Ligjin për marrëdhënie pune dhe nëse në rastin konkret për këtë kategori të punësuarve duhet të zbatohet Ligji për marrëdhënie pune.

Sektor i veprave civile të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke shqyrtuar mbi çështjen e parashtruar juridike miratoi mendim juridik për këto arsye:

Sipas nenit 117 paragrafi (4) të Ligjit për marrëdhënie pune, punëtori i cili ka punuar mbi 150 orë më tepër nga orari i plotë i punës, dhe nuk ka munguar nga puna më shumë se 21 ditë gjatë vitit të njëjti punëdhënës, punëdhënësi obligohet që t'i paguajë krahas rrogës shtesë edhe bonus në lartësi prej një rroge neto mesatare në Republikë.

Sipas nenit 128 paragrafi (1) të Ligjit për marrëdhënie pune, punëtori i cili punon së paku tri orë nga obligimi i tij punues ditor i rregullt, përkatësisht punëtori që punon natën një të tretën e orarit të plotë të punës nga obligimi i tij vjetor i punës, ka të drejtë për mbrojtje të veçantë për punën e natës ndërsa sipas paragrafit (3) pika 2 nga i njëjti nen punëdhënësi me shpenzimet e tij obligohet që punëtorëve të cilët punojnë natën t'u sigurojë ushqim përkatës apo sipas ndryshimit të bërë në Ligjin për marrëdhënie

pune në atë nen (“Gazeta Zyrtare e RM” nr.120/18 të datës 29.06.2018), kompensim të shpenzimeve për ushqim në lartësi prej 20% nga rroga neto mesatare për punëtor të paguar në Republikën e Maqedonisë në vitin e kaluar, proporcionalisht për ditët kur punëtori punon natën.

Sipas nenit 3 paragrafi (3) të Ligjit për shërbim gjyqësor, policia gjyqësore të drejtat për marrëdhënie pune i realizojnë në pajtim me këtë ligj, Ligjin për gjykatat, Marrëveshjet kolektive dhe dispozitat tjera të cilat i përcaktojnë të drejtat për marrëdhënie pune.

Me Vendim të Gjykatës kushtetuese U.nr.53/2014-1 të datës 08.10.2014 është anuluar neni 3 paragrafi (3) të Ligjit për shërbim gjyqësor, në pjesën “edhe dispozitat tjera të cilat i përcaktojnë të drejtat për marrëdhënie pune” me arsyetim se paraqet nocion shumë të gjerë dhe të pacaktuar, që nuk ka bazë kushtetuese nëse udhëzon në akte nënligjore të miratuara në funksion të përpunimit të një ligji të caktuar.

Duke qenë se nga arsyetimi i Vendimit të theksuar të Gjykatës kushtetuese U.nr.53/2014-1 të datës 08.10.2014 rrjedh se nëse nocioni “edhe dispozitat tjera të cilat i përcaktojnë të drejtat për marrëdhënie pune”, udhëzon në zbatimin e një ligji tjetër ka bazë kushtetuese, zbatohet Ligji për marrëdhënie pune të kësaj kategorie të punësuarve në policinë gjyqësore, për arsye se me të, rregullohen të drejtat nga marrëdhënia e punës, duke përfshirë edhe dispozitat e shënuara në nenin 117 paragrafi (4) dhe nenin 128 paragrafi (1) dhe (3) të Ligjit për marrëdhënie pune. Të drejtat e theksuara nga marrëdhënia e punës në dispozitat ligjore të vëra në dukje, nuk janë përcaktuar në Ligjin për shërbim gjyqësor, por të punësuarit në policinë gjyqësore mund t’i realizojnë sipas kushteve të përcaktuara në Ligjin për marrëdhënie pune. Ky ligj, përcakton zbatimin edhe sa i përket të punësuarve në policinë gjyqësore, sipas nenit 3 nga i njëjti ligj, për arsye që sipas dispozitës së këtij neni, me të rregullohen edhe marrëdhëniet e punës për të punësuarit në organet e pushtetit shtetëror. Të punësuarit në policinë gjyqësore si pjesë e shërbimit gjyqësor, janë persona të punësuar në gjykatat që si organe shtetërore realizojnë pushtetin gjyqësor.

GJYKATA SUPREME
E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
Sektori i veprave civile